

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ALB-ENERGY" sh.p.k është themeluar më 14 shkurt 2015 dhe është regjistruar më 3 mars 2015 në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është ndërtimi, operimi, administrimi, mirëmbajtja, shfrytëzimi dhe transferimi i hidrocentraleve, si dhe marrja përsipër e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kontrata koncessionare., prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike, si dhe çdo lloj veprtimatrie dytësore që lidhet me veprimtarinë kryesore.

Administrator i Shoqërisë është Z. Pëllumb Beta.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L51503039D. Selia gendrore e saj është në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga Asim Vokshi, Nd.14, H.4, Ap.6, 1016.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 17 punonjës. (2019: 18 punonjës). Numri i punonjësve në fund të vitit 2020 i ndarë sipas kategorive është:

- 1 administrator
- 1 ekonomiste
- 1 elektriçist
- 1 inxhinier
- 1 mekanik
- 1 mjeke
- 6 operatorë kompjuterash
- 1 punëtor
- 3 roje sigurimi
- 1 shofer

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimë dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financier, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimesht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të janë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimë dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të jetë më shumë se 50%, në të tillë raste shoqëria provizonon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të jetë më shumë se 50% në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tillë raste shoqëria provizonon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të jetë më shumë se 50% në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3 Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese kanë filluar te lehtesohen, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsyë vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/Lek	123.70	121.77
USD/Lek	100.84	108.64

3.2 Instrumentat finanziarë

Instrumentat finanziarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat finanziarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvèç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat finanziarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë périudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktivet afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të viti.

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivit do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët. Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

v. Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivet jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë te periudhës koncesionare.

3.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët. Një aktiv jo-material matet fillimi sht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivet jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë te periudhës koncesionare.

3.5.1 Marrëveshjet Koncessionare

Një marrëveshje koncessionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (koncessionshënesi) kontrakton një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivet e infrastrukturës së koncessionshënesit si rrugë, ura, tuneli, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, koncessionshënesi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënës në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.

Shoqëria ka njohur aktivet e e krijuara nga marrëveshja koncessionare sipas modelit të Aktivit Jomaterial.

Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkësat e SKK5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvëç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvëç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimin të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferençash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontribute të pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukset parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrit, provizonet rimerren.

3.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financier dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Mjete monetare në bankë		
Në Lekë	79,024,423	35,431,580
Në monedhë	66,313,322	143,481,168
Depozita Afatshkurtra fleksibël	39,228,297	39,208,892
Mjete monetare në arkë		
Në Lekë	169,582	633,473
Në monedhë	242,575	787,121
	184,978,199	219,542,234

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Klientë	14,469,787	-
	14,469,787	-

6. Llogari tatimore të arkëtueshme

Llogaritë tatimore të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagim i tatimit mbi fitimin	12,877,087	15,662,950
	12,877,087	15,662,950

7. Të ardhura të përllogaritura

Të ardhurat e përllogaritura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Klientë për energji të prodhuar të pafaturuar	17,115,595	56,226,642
	17,115,595	56,226,642

8. Inventarë

Vlera e inventarit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Materiale të para	14,183,367	11,890,057
Inventar i imët	1,739,106	1,753,034
Zhvleresimi inventarit të imët	(943,419)	(943,419)
	14,979,054	12,699,672

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shpenzime të periudhave të ardhme	1,429,082	1,421,228
Parapagime përfurnitorë	-	52,425
Paradhënie përpunonjësit	110,309	-
	<u>1,539,391</u>	<u>1,473,653</u>

10. Aktive financiare

Llogaria e aktiveve financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Depozita afatgjata në bankë	18,800,000	18,800,000
	<u>18,800,000</u>	<u>18,800,000</u>

11. Aktive Afatgjata Materiale

Kosto	Mjete transporti	Makineri dhe pajisje	Pajisje informatike dhe teknike	Mobilje e pajisje zyre	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	6,034,313	2,731,692	5,484,364	156,475	2,188,968	16,595,812
Shtesa			8,712	16,667	1,310,210	1,335,589
Gjendja më 31 dhjetor 2019	6,034,313	2,731,692	5,493,076	173,142	3,499,178	17,931,401
Shtesa				42,457		42,457
Gjendja më 31 dhjetor 2020	6,034,313	2,731,692	5,535,533	173,142	3,499,178	17,973,858
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 1 janar 2019	2,938,842	1,541,006	3,472,495	73,514	1,193,474	9,219,331
Amortizimi i viti	619,094	238,137	503,511	16,592	371,212	1,748,546
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,557,936	1,779,143	3,976,006	90,106	1,564,686	10,967,877
Amortizimi i viti	495,275	190,510	379,268	16,607	386,898	1,468,558
Gjendja më 31 dhjetor 2020	4,053,211	1,969,653	4,355,274	106,713	1,951,584	12,436,435
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,476,377	952,549	1,517,070	83,036	1,934,492	6,963,524
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,981,102	762,039	1,180,259	66,429	1,547,594	5,537,423

12. Aktive Afatgjata Jomateriale (Konçensioni)

	HEC BELE 2	HEC TOPOJAN 1	Pjesa e Nëinstacionit	Rrethimi i Objektit	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2019	1,198,256,119	679,189,202	229,733,453	5,089,873	2,112,268,647
Pakësimë					-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,198,256,119	679,189,202	229,733,453	5,089,873	2,112,268,647
Shtesa					-
Transferime					-
Pakësimë					-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,198,256,119	679,189,202	229,733,453	5,089,873	2,112,268,647
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 1 janar 2019	223,526,476	112,148,107	36,153,507	553,836	372,381,926
Zhvlerësimi i vittit	37,447,500	21,809,273	7,445,383	169,919	66,872,075
Pakësimë					-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	260,973,976	133,957,380	43,598,890	723,755	439,254,001
<i>Zhvlerësimi i vittit</i>					
Pakësimë					-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	298,420,170	155,766,653	51,044,273	901,855	506,132,951
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2019	937,282,143	545,231,822	186,134,563	4,366,118	1,673,014,646
Gjendja më 31 dhjetor 2020	899,835,949	523,422,549	178,689,180	4,188,018	1,606,135,696

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dështit e vitit e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

13. Hua

Llogaria e huave më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë nga OTP	52,333,103	51,516,625
Kredi afatgjatë OTP	251,904,239	299,490,587
	<u>304,237,342</u>	<u>351,007,212</u>

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaria e të pagueshmeve tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme tregtare	21,761,917	16,312,287
	<u>21,761,917</u>	<u>16,312,287</u>

15. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
TVSH për t'u paguar	887,456	7,674,910
Tatim në burim	66,798	65,756
Detyrime për sigurime shoqërore	261,218	272,067
dhe shëndetsore		
Detyrimi për tatimin mbi të	78,630	81,798
ardhurat personale		
Të tjera	<u>1,294,102</u>	<u>881</u>
		<u>8,095,412</u>

16. Të tjera detyrime

Llogarite e detyrimeve të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga për t'u paguar	-	281,564
Dividendë të pagueshmë	2,603,528	-
	<u>2,603,528</u>	<u>281,564</u>

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2020 ishte 17 punonjës (2019: 18 punonjës)

ALB-ENERGY sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

17. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Hua nga palët e lidhura - Alb Buliding	147,679,122	147,679,122
	<u>147,679,122</u>	<u>147,679,122</u>

18. Kapitali

Vlera e kapitalit të nënshkruar më 31 dhjetor 2020 është 47,160 lekë i ndarë në 3 kuota. 1 kuotë në vlerë 7,157.94 lekë zotërohet nga Bradaj 2, 1 kuotë në vlerë 11,158 lekë zotërohet nga Kadria dhe 1 kuotë prej 28,844.06 lekë e zotëruar nga ALB-Building.

Fitimi për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2020 është 217,848,497 ALL. (Për vitin 2019: 257,298,426 ALL).

Fitimi i akumular për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2020 është 887,742,752 ALL. (Për vitin 2019: 917,695,726 ALL)

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti I shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shitje energji elektrike	415,146,222	440,415,725
	<u>415,146,222</u>	<u>440,415,725</u>

20. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Fitim (Humbje) nga këmbimet valutore për marrëdhënie tregtare	(100,034)	433,217
	<u>(100,034)</u>	<u>433,217</u>

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

20. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	392,688,445
Shtohen faturimet për tarifen e koncesionit	22,457,777
Zbriten humbjet nga këmbimet valutore për marrëdhene tregtare	(100,034)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	415,046,188
Sipas Kontabilitetit	415,046,188
Diferencia	-

21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Mallra të tjera	116,109	1,996,047
Mirëmbajtje dhe riparime	13,652,565	12,792,235
Tatime lidhur me energjinë	20,757,311	22,020,786
	34,525,985	36,809,068

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Blerje, Energji, Avull, ujë karburant	1,272,949	1,688,924
Shpenzime qiraje	475,920	475,372
Mirëmbajtje dhe riparime	181,685	141,487
Sigurime	1,421,228	1,397,032
Pjesë këmbimi	26,500	234,137
Blerje të ndryshme, kancelari	-	8,292
Kosto e punimeve	1,143,708	45,450
Shërbim roje fizike	6,183,856	4,578,700
Shpenzime të tjera	3,248,624	4,745,552
Shpenzime transporti	1,265,028	1,615,347
Tarifë licencimi ERE	1,548,665	-
Komisione bankare	96,992	104,222
Taksa të ndryshme	8,119,878	9,012,618
	24,985,033	24,047,133

Në shpenzimet e tjera kemi të përfshira edhe shpenzimet për qëllim auditimi vjetor nga shoqëria Mazars sh.p.k në vlerën 500,000 Lekë.

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime paga	13,465,188	14,580,012
Shpenzime përsigurime shoqërore e shendetësore	1,925,770	1,980,017
	<u><u>15,390,958</u></u>	<u><u>16,560,029</u></u>

24. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime amortizimi	68,347,508	68,620,621
	<u><u>68,347,508</u></u>	<u><u>68,620,621</u></u>

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Gjoba dhe dëmshpërblime	14,248	-
	<u><u>14,248</u></u>	<u><u>-</u></u>

26. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare neto përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime përi interesat	(10,035,369)	(11,546,304)
Të ardhura nga interesat	282,811	871,521
	<u><u>(9,752,558)</u></u>	<u><u>(10,674,783)</u></u>

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lekë)

27. Shpenzimet e tjere financiare

Shpenzimet e tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti financier	19,763	23,953,762
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti financier	(3,270,064)	(2,960,905)
	<u>(3,250,301)</u>	<u>20,992,857</u>

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitmin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Fitimi para tatimit</i>		
Total shpenzime të panjohura	258,779,597	305,130,165
Shpenzime amortizimi	14,094,405	13,748,092
Shpenzime të tjera	12,748,600	12,748,601
	<u>1,345,805</u>	<u>999,491</u>
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>272,874,002</u>	<u>318,878,257</u>
<i>Tatim fitimi @15%</i>		
	<u>40,931,100</u>	<u>47,831,739</u>
	<u><u>217,848,497</u></u>	<u><u>257,298,426</u></u>

29. Palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhetor 2020 dhe 31 dhetor 2019 detajohen më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Detyrim per dividend	-	2,603,528	-	-
Hua nga Alb Building	-	147,679,122	-	147,679,122
	<u>-</u>	<u>150,282,650</u>	<u>-</u>	<u>147,679,122</u>

Shpërblimi menaxhimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 2,160,276 lekë.

ALB-ENERGY sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lekë)

30. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financier të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

31. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkojnë rregullime ose shënimë shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.